



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1599, datë 22.04.2011

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1502, datë 10.02.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Altelecom sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.04.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1502, datë 10.02.2011 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Altelecom sh.a” të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);
- Projekt Vendim i KD (*Projektakti*);
- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);

2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1502, datë 10.02.2011 i KD të AKEP “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Alblecom sh.a”;
2. Shkresë Alblecom sh.a nr. 1119 prot, datë 25.02.2010 (AKEP: nr. 74/5 prot, datë 25.02.2011) “Mbi depozitimin e pretendimeve të Alblecom sh.a mbi mosmarrëveshjen me AMC sh.a ”;
3. Shkresë e AMC sh.a nr. 4460/9, datë 25.02.2011 (AKEP: nr.74/4 prot, datë 25.02.2011), “Përgjigje mbi Vendimin nr. 1502 date 10.02.2011 për “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Alblecom sh.a”;
4. Shkresë e AMC sh.a nr. 4460/10, datë 09.03.2011 (AKEP: nr. 293/11 prot, datë 09.03.2011), “Në vazhdim të procedimit mbi Vendimin nr. 1502 date 10.02.2011 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Alblecom sh.a”;
5. Seanca dëgjimore e zhvilluar me datë 03.03.2011 në selinë e AKEP midis palëve;
6. Korrespondencat shkresore midis palëve e depozituara nga AMC sh.a dhe Alblecom sh.a;
si dhe
7. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen,
8. Bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R Ë N:

- I. Sipërmarrësi Alblecom sh.a me shkresën nr.1119 prot, datë 25.02.2010 (AKEP: nr. 74/5 prot, datë 25.02.2011) “Mbi depozitimin e pretendimeve të Alblecom sh.a mbi

mosmarrëveshjen me AMC sh.a”, paraqet në mënyrë të përmbledhur argumentat ligjore dhe teknik si më poshtë:

1. Albtelecom konsideron se skema funksionale e interkoneksionit e paraqitur edhe në MI me secilin nga operatorët mobile të interkonektuar me Albtelecom, interkoneksioni realizohet me centralet tranzite të Albtelecom;
2. Albtelecom i referohet topologjisë dhe arkitektures së rrjetit të Albtelecom dhe shkallës së hierarkisë së centraleve të interkoneksionit, ku lidhja në centralet tranzite përcakton terminimin në segment të dyfishtë, duke patur parasysh parimin ligjor të mbulimit të kostove që Albtelecom i shkaktohen për ofrimin e shërbimit të terminimit për operatorët e telefonisë së lëvizshme;
3. Albtelecom thekson se, aplikon terminimin në segmente lokal, njëfish dhe dyfish vetëm për operatorët alternativë që janë të autorizuar të operojnë në zona të caktuara gjeografike për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse në bazë të numeracionit përkatës të miratuar nga AKEP specifikisht për këto zona. Ky segmentim i detyrohet tarifës që i ngarkohet abonentit duke iu referuar konceptit të numrit gjeografik në shërbimet dhe rrjetet e telefonisë fikse;
4. Albtelecom vlerëson se, numeracioni i operatorëve mobile i përket konceptit të numrave jo gjeografikë dhe nuk i përkasin një rajoni gjeografik të caktuar çka bën të detyrueshëm realizimin e interkoneksionit në centralet tranzite të cilët bëjnë të mundur terminimin e thirrjeve në të gjithë rrjetin Albtelecom dhe e anasjellta, e cila sjell si pasojë aplikim të një tarife të vetme për terminim në rrjetet respective dhe rrjedhimisht abonentët tarifohen njëllëj pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike brënda zonës kombëtare;
5. Gjithashtu, centralet lokale dhe rajonale të Albtelecom nuk mundësojnë terminimet në segment lokal dhe njëfish pa u shoqëruar me kosto shtesë për Albtelecom. Kjo përbën një fakt të mirënjohur për AKEP dhe AMC, pasi edhe në RIO të Albtelecom është specifikuar si e tillë, por është pranuar që për operatorët alternativë të cilët shërbejnë zona gjeografike të caktuara transporti i trafikut nga pika e interkoneksionit deri në centralet tranzite të Albtelecom të përballohen nga vetë Albtelecom;
6. Albtelecom konsideron se, Operatorët Alternativë kanë një shtrirje rrjeti në një zonë gjeografikë të kufizuar, e cila mbulohet vetëm nga një central lokal;
7. Albtelecom vlerëson se pozicioni i tij si ndërmjetës në lidhjen e rrjetit të operatorëve Alternativë me rrjetet mobile, referuar skemës të lidhjes përcakton interkoneksion të dyfishtë:
 - i. Lidhja e Op.Alternative-Albtelecom (rrjete të së njëjtës natyrë)
 - ii. Lidhja e Albtelecom-Mobile;

Duke arsyetuar se:

Lidhja e Operatorëve Alternative me Albtelecom përcakton ndarjen e kostove dhe detyrimeve me segmente të secilit sipas vendndodhjes dhe pikës së interkoneksionit. Pjesa tjetër Albtelecom - Mobile përcakton koston dhe detyrimin për tranzitim të dyfishtë që kryen Albtelecom për operatorët mobile, segmentin nga DTA deri në CT Lokal Albtelecom,

Operatorët Alternativë janë të lidhur më Operatorët Mobile nëpërmjet Albtelecom. Detyrimi që operatorët mobile paguajnë, mbulon përkatësisht kostot për terminimin në rrjetin e Operatorëve Alternativë dhe koston për tranzitimin e trafikut nga DTA deri në Pikën e Interkoneksionit të operatorit alternativë me centralin përkatës lokal të Albtelecom. Nëse do të analizohej hierarkia e lidhjes së centraleve dhe nëse do të merrnin për referencë Rajonin e Tiranës, kostot që mbulojnë shërbimin nga pika e interkoneksionit të Operatorëve Mobile drejt një pajtimtari të Albtelecom të Rajonit Albtelecom Tiranë është e barazvlefshme me kostot e shërbimit transit plus detyrimin për Op. Alternativë.

8. Albtelecom argumenton se, është duke kryer investime të rëndësishme në rrjetin e tij për të implementuar teknologjitë e reja NGN dhe nuk ka asnjë kuptim që të investojë në teknologjinë e vjetër në centralet TDM për të mundësuar funksionalitetin e plotë të tyre;
9. Albtelecom thekson se, praktika Europiane të interkonektimit të rrjeteve mobile me rrjetet fiks sygjeron që niveli i hierarkisë së rrjetit fiks ku ofrohet interkoneksioni me operatorët mobile është centrali transit kombëtar;
11. Për sa më sipër Albtelecom beson se, faktorë si më sipër të cilët reflektojnë situatën aktuale të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë janë patur parasaysh edhe nga AKEP në procesin e hartimit, konsultimit dhe miratimit të Rregullores nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” e miratuar me Vendimet nr.1300, datë 14.06.2010, ku në pikën 5, të nenit 5, të saj është përcaktuar si më poshtë:

“Marrëveshjet e interkoneksionit dhe ofertat e referencës mund të përmbajnë rregulla të cilat parashikojnë që disa tipe të caktuara të thirrjeve të telefonisë me zë duhet të dorëzohen në disa pika të caktuara interkoneksioni”;

- II. Sipërmarrësi AMC sh.a me shkresën nr. 4460/9, datë 25.02.2011 (AKEP: nr. 74/4 prot, datë 25.02.2011), “Përgjigje mbi Vendimin nr. 1502 date 10.02.2011 për “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Albtelecom sh.a”, në vijim të argumentave të paraqitura në ankimin me skrese nr.4490/6 prot, datë 18.01.2011, AMC sqaron se:
 1. Kompanit Mobile të cilat janë deklaruar nga AKEP, si SMP në tregun e terminimit të thirrjeve është aprovuar nga AKEP:
 - RIO me datë 13.12.2010
 - Projektin i koston BULRAIC 10.02.2011.
 2. Ndërkoh AMC për Albtelecom thekson se edhe pse është deklaruar SMP në tregun e terminimit të thirrjeve nuk është aprovuar ende nga AKEP:
 - RIO edhe pse procesi për përditësimin e RIO se Albtelecom ka filluar në të njëjtën kohë me kompanitë mobile;

- Projekti i kosos BULRAIC Albtelecom për të cilin rezultatet paraprake për Konsultimin Publik janë zhvilluar në periudhën 11.06.2010 dhe 10.07.2010

3. AMC vlereson se në rezultatet e modelit BULRAIC të Albtelecom të publikuara në faqen e internetit të AKEP, në këtë model kostojë AKEP më parasysh taifën për thirrje e cila shfaqet ketu 0.24 lek/thirrje, ndërsa në modelet e aprovuara për shoqërit mobile tarifa për thirrje përjashtohet.

Për sa më sipër AMC konsideron se ka një tarifë 0.83 lek/thirrje nga ana e operatorit Albtelecom dhe një tarifim 0 lek/min nga ana e operatorit Mobile.

Gjithashtu AMC thekson se për terminimin dyfish sipas tabelës në këtë model kostojë është 1.84 lek/min, ndërsa tarifa e prezantuar në Vendimin e AKEP është 3.5 lek/min e cila është dyfish i kostos së përllëgaritur në këtë dokument, po e njëjta logjik ndiqet për terminimin në segment lokal apo në segment 1 fish duke përfshirë edhe tarifën e tranzitimit.

4. Për sa më sipër AMC bazuar edhe në nenin 120 të Ligj nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” kërkon që:

- AKEP të ndërhyjë dhe të zgjidhë çështjen mbi diferencimin e tarifës sipas segmentimit lokal njëfish dhe 2 fish për trafikun hyrës celular të AMC që terminohet në rajone të Abtelecom duke filluar me rajonin e Tiranës në linjë me çmimet e Albtelecom të miratuara me VKD nr. 1348, datë 26.07.2010 të AKEP duke rikonfiguruar skemat e interkoneksionit për eliminimin e hallkave dhe kostove shtesë të panevojshme;

- Albtelecom të zbatojë Vendimin nr. 1348 datë 26.07.2010 të AKEP, në të cilin citohet se tarifimi do të bëhet sipas segment lokal, i njëfishtë apo i dyfishtë ku në të cilin nuk ka asnjë citim se zbatimi i diferencimit në tarifa sipas segmenteve zbatohen vetëm për operatorët alternative me rrjete fikse që janë të autorizuara të operojnë në zona të caktuara gjeografike për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse;

- AKEP të veprojë në të njëjtën rrugë për uljen e kostove të interkoneksionit si dhe për të gjithë procedurat e tjera për të gjithë kompanitë FNT në tregun e terminimit të thirrjeve duke zbatuar parimn e transparencës, të mos diskriminimit dhe barazisë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;

5. Sipërmarrësi AMC sh.a me shkresën nr. 4460/10, datë 09.03.2011 (AKEP: nr. 293/11 prot, datë 09.03.2011) “Në vazhdim të procesit mbi Vendimin nr. 1502, datë 10.02.2011”, sqaron se:

- Tarifimi i shërbimit të terminimit të trafikut nuk është në përputhje me termat dhe përcaktimet e RIO-s në fuqi. Aktualisht Albtelecom tarifon AMC sipas vetëm një kategorie “terminim në segment dyfish”, pra kemi të bëjmë me të njëjtën tarifë si në rastin kur thirrja terminohet në një abonent të Albtelecom në Tropojë apo Gjirokastrë ashtu edhe atëherë kur abonenti i Albtelecom ndodhet në Tiranë. Sipas RIO përkufizimet për shërbimin e terminimit të trafikut janë si më poshtë:

- **Terminim në segment lokal:**

Terminim në të cilin pika e interkoneksionit midis operatorit Përfitues dhe Albtelecom dhe pika fundore e rrjetit të Albtelecom ndodh në të njëjtën zonë lokale të rrjetit terminues të Albtecom;

- **Terminim në segment njëfish:**

Terminimi në të cilin pika e interkoneksionit midis operatorit përfitues dhe Altelecom dhe pika fundore e rrjetit Altelecom ndodhen në të njëjtën zonë rajonale të rrjetit terminues të Altelecom;

- **Terminim në segment dyfish:**

Terminimi në të cilin pika e interkoneksionit midis operatorit përfitues dhe Altelecom dhe pika fundore e rrjetit terminues ndodhen në zona të ndryshme rajonale të rrjetit terminues Altelecom.

Për sa më sipër AMC i referohet përcaktimit të terminimit në segment lokal dhe sqaron se për zonën e Tiranës centrali i AMC ndodhet në Tiranë, centrali i Altelecom ndodhet në Tiranë, dhe se AMC është operatori përfitues në këtë rast. Terminimi në pikat e interkoneksionit midis AMC dhe Altelecom dhe pika fundore e rrjeti Altelecom ndodhen në të njëjtën zonë lokale të rrjetit terminues të Altelecom, pra në Tiranë për zonën e Tiranës ndodhen në të njëjtën zonë lokale;

Gjithashtu AMC thekson se sipas përkufizimit “Terminim në segment lokal” mjafton që pika e interkoneksionit midis AMC dhe Altelecom dhe pika e fundore e rrjetit të Altelecom të ndodhen në të njëjtën zonë lokale të rrjetit terminues të Altelecom në mënyrë që tarifimi të jetë sipas kategorisë, “segment lokal”, AMC konsideron se ky është rasti i për thirjet e terminuara tek abonentet e Altelecom që ndodhen në Tiranë (me seritë numerike përkatëse). Pra nuk ka rëndësi nëpër sa nyja (centrale) kalon thirrja brenda rrjetit Altelecom, për sa koh ato ndodhen në të njëjtën zonë lokale;

6. AMC edhe në rastin kur Altelecom pretendon se tarifimi duhet të jetë segment i dyfishtë sepse interkoneksioni nuk realizohet direkt në centralin lokal, AMC deklaron se është e gatshme të interkonektohet lokalisht në të gjitha centralet rajonale të Altelecom.

7. AMC konsideron se në faqen 5 të RIO theksohet se:

“Operatori përfitues ka të drejtë të interkonektohet me Altelecom në secilën prej pikave të interkoneksionit të cituara më sipër sipas zgjedhjes së tij”

Për sa më sipër AMC kërkon të rishikohet tarifimi për terminimin e trafikut duke e ndarë atë sipas kategorive të përcaktuara në RIO, ku nuk është e nevojshme të pritet për ndryshime në topologji, për të cilat Altelecom mund të ketë vështirësi dhe kosto për t'i realizuar edhe pse është i detyruar sipas citimit më sipër të RIO-s;

8. AMC për zonën e Tiranës kërkon segmentim lokal dhe për zonat e tjera sipas përcaktimeve të rajoneve;

9. Gjithashtu AMC propozon një tarifë të ponderuar që merr parasysh përqindjen e trafikut sipas kategorive.

III. AKEP, në seancën dëgjimore të mbajtur në selinë e AKEP me datë 03.03.2011 midis palëve në procedim vëren se:

- AMC ka mbrojtur argumentin se meqënëse pika e interkonksionit AMC-Altelecom është në Tiranë, AMC duhet të përfitojë tarifë terminimi lokale ose njëfish për thirrjet

drejt abonentëve të Altelecom që ndodhen në Tiranë. AMC ka pranuar tarifë terminimi dyfish ndër vite, por me ndryshimin e kushteve të tregut dhe rritjen e tarifave të terminimit të Altelecom kërkon që të aplikohet tarifa e terminimit lokale për Tiranën dhe njëfish për rajonet e tjera.

- Palëve ju është sqaruar nga AKEP se në RIO aktuale të Altelecom tarifa e terminimit të aplikuar varet nga lloji i pikës së interkoneksionit në të cilin është lidhur operatori: një operator mund të përfitojë tarifë terminimi lokal për thirrjet drejt abonentëve të Altelecom të lidhur me centralin lokal përkatës nëse operatori është i lidhur në atë pikë lokale interkoneksioni.
- AMC ka komentuar se është gatshme të shkojë me infrastrukturën e vet në pikat lokale dhe rajonale të interkoneksionit të Altelecom.
- Altelecom është shprehur se nuk ka mundësi teknike të pranojë trafik në centrale lokale nga OC. Në rast të tillë për Tiranën, OC duhet të lidhen në secilin prej tre centraleve lokale të Altelecom në Tiranë. Dhe në rast të tillë, Altelecom do të duhet të rrisë kapacitete të këtyre centraleve, gjë e cila do të ishte e përkohshme dhe investimi shtesë do të shkonte dëm, pasi struktura e rrjetit Altelecom po shkon drejt NGN/NGA.
- AMC është shprehur se për Altelecom duhet të aplikohen tarifat e terminimit sipas kostove BULRAIC ashtu si dhe për operatorët celularë. Mos aplikimi i tyre përbën diskriminim ndaj operatorëve celularë, për të cilët AKEP ka marrë tashmë vendim për aplikimin e rezultateve të modelit BULRAIC.
- Palët janë sqaruar se për aplikimin e tarifave të Altelecom sipas kostove BULRAIC do të veprohet si me telefoninë celulare dhe do të zhvillohet një konsultim publik së shpejti nga AKEP.

IV. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se:

1. Interkoneksioni në rrjetin fikse të operatorit inkumbent Altelecom është përcaktuar nga AKEP të realizohet në tre nivele, lokal, njëfish dhe dyfish, dhe në bazë të segmentit përkatës aplikohen dhe tarifat përkatëse të terminimit të thirrjeve. Aplikimi i segmenteve të terminimit varet nga lidhja midis pikës së interkoneksionit ku dorëzohet thirrja dhe vendndodhjes së pajtimatrit në rrjetin e Altelecom. Këto përcaktime janë dhënë në faqet 5-8 të RIO-s së Altelecom të miratuar me vendimin e AKEP nr.630, datë 10.02.2009, si më poshtë:

Pikë interkoneksioni kombëtare që ndodhet (apo lidhet me) në centralet tranzit kombëtare në Tiranë dhe Durrës dhe shërbejnë për interkoneksion me rrjetin Altelecom për terminimin e thirrjeve drejt gjithë përdoruesve të rrjetit Altelecom dhe për tranzitimin e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera të interkonektuar me Altelecom.

Pikë interkoneksioni rajonale që ndodhet (apo lidhet me) në centralin tranzit rajonal të Altelecom dhe shërbejnë për interkoneksion me rrjetin Altelecom për terminimin e thirrjeve drejt gjithë përdoruesve të rrjetit Altelecom dhe për tranzitimin e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera të interkonektuar me Altelecom.

Pikë interkoneksioni lokale që ndodhet (apo lidhet me) në central lokal të Albtelecom dhe shërbejnë vetëm për terminimin e thirrjeve drejt perdoruesve fundore të Albtelecom që janë ë lidhur me këtë central lokal.

Terminim në segment lokal: terminimi i thirrjeve që dorezohen në pikë lokale interkoneksioni dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, serite numerike të të cileve i përkasin centralit lokal në të cilën ndodhet pika e interkoneksionit.

Terminim në segment njëfish: terminimi i thirrjeve që dorezohen në pikën e interkoneksionit rajonale dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom, seritë numerike të të cilëve i përkasin centraleve lokale të lidhur me centralin rajonal në të cilin ndodhet pika e interkoneksionit.

Terminim në segment dyfish: terminimi i thirrjeve që dorezohen në pikën e interkoneksionit dhe terminohen tek perdoruesit e Albtelecom seritë numerike të të cileve i përkasin centraleve lokale të lidhur me një central rajonal të ndryshëm nga centrali rajonal në të cilën ndodhet pika e interkoneksionit.

2. Përkufizimet dhe sqarimet e mësipërme janë pjesë e RIO të Albtelecom të miratuar me VKD nr.630, datë 10.02.2009, dhe prevalojnë mbi përkufizimet e dhëna në seksionin Përkufizime në të njëjtin dokument, pasi përmbajnë sqarime më të detajuara të segmenteve të terminimit dhe pikave të interkoneksionit të Albtelecom. Gjithashtu sqarimet apo detajimet e mësipërme janë dhënë edhe në dokumentat e analizave të tregut në 2007 dhe 2010 për telefoninë fikse si dhe janë përputhje me praktikat ndërkombëtare të ndarjes së segmenteve të terminimit në rrjet fiks.
3. Ndarja e segmenteve të terminimit dhe pikave të interkoneksionit të Albtelecom është bërë në analogji me tarifatat e thirrjeve brënda rrjetit Albtelecom : lokale, rajonale dhe kombëtare.
4. Per sa më sipër, një operator mund të përfitojë:
 - a. terminim lokal: vetëm për thirrjet që dorezohen në pikën lokale të interkoneksionit dhe që terminohen tek abonentet e lidhur me centralin lokal përkatës: thirrje drejt aboneteve që kanë numra që shërbehen nga ky central lokal. Pika lokale e interkoneksionit pranon thirrje vetem drejt këtyre numrave.
 - b. Terminim segment njëfish: vetëm për thirrjet që dorezohen në një pikë rajonale interkoneksioni dhe që kanë destinacion abonente në central lokale që janë të lidhur me këtë central rajonal. Pika rajonale mund të përdoret edhe për të dërguar thirrje drejt rajoneve të tjera, dhe në këtë rast tarifa e terminimit është segment dyfish.
 - c. Në rast se thirrja dorëzohet në një pikë kombëtare interkoneksioni, tarifa që duhet të paguhet është terminim në segment dyfish, pavarësisht se pika kombëtare e interkoneksionit dhe pajtimtari i Albtelecom ku terminohet thirrja mund të jenë në të njëjtin qytet apo zonë lokale për tarifimin retail.

5. Në bazë të argumentave të Altelecom ndër vite rezulton se për shkaqe teknike të menaxhimit të rrjetit, rrugëzimi i thirrjeve që dorëzohen në pikat lokale të interkoneksionit kryhet jo në centralin lokal, por nëpërmjet centraleve tranzite kombëtare: thirrja dorëzohet në pikë lokale interkoneksioni dhe me pas Altelecom dergon thirrjen në një nga dy centralet tranzit kombëtare (Tiranë ose Durrës) dhe kjo thirrje kthehet në centralin lokal ku terminohet tek pajtimatri. Kjo skemë aplikohet edhe për thirrjet e dorëzuara në central rajonal. Këto skemë megjithëse përfshijnë rrugëzim të thirrjeve me të madh se terminimi lokal apo njëfish (pra dhe koso me të lartë, aplikohet për thirrjet e operatoreve alternative pa kosto shtese për këta operatore. Ky tarifim është imponuar nga AKEP duke u bazuar në rendësinë që kanë segmentet e tarifimit të terminimit në aftësinë konkurruese të operatoreve alternative me Altelecom në shërbimet telefonike në nivelin me pakicë të telefonisë fikse, sidomos të thirrjeve lokale. Ky detyrim ishte pjesë edhe e Projekt-RIO të Altelecom në fund të vitit 2010, varianti final i së cilës është në proces vendim-marrje nga AKEP. Gjithashtu në këtë variant, është konkluduar që segmenti lokal i terminimit të jetë i disponueshëm vetëm për thirrjet e abonenteve të OA dhe jo për thirrjet e tranzituara (hyrese ndërkombëtare). Në bazë të RIO të propozuar nga Altelecom, thirrjet hyrese ndërkombëtare dhe nga rrjetet celulare do të pranohen vetëm në pika kombëtare interkoneksioni, pra dhe me tarife në segment dyfish. Propozimi i Altelecom është mbështetur në Rregulloren e Akses Interkoneksionit (neni 5, pika 5):

Marrëveshjet e interkoneksionit dhe ofertat e referencës mund të përmbajnë rregulla të cilat parashikojnë që disa tipe të caktuara të thirrjeve të telefonisë me zë duhet të dorëzohen në disa pika të caktuara interkoneksioni.

6. Historikisht OC janë interkonektuar vetëm në central transit me Altelecom dhe kanë paguar tarifë terminimi segment dyfish. RIO e vitit 2009 nuk pengon OC të lidhen në pika të tjera interkoneksioni si lokale dhe rajonale, megjithatë në MI-t e nënshkuara sipas kësaj RIO operatorët kanë rënë dakort me pikë kombëtare interkoneksioni.
7. Parimisht tarifat e terminimit dhe aksesit në pika interkoneksioni nuk varen nga origjina e thirrjes: fiks apo celulare, dhe operatorët celulare kanë të drejtë të përfitojnë tarifa lokale dhe/ose njëfish nëse ata interkonektohen në pika lokale dhe/ose rajonale interkoneksioni. Tarifimi kryhet sipas përcaktimeve të dhëna më sipër dhe RIO të Altelecom.
8. Ndërkohë përveç përcaktimit në pikën 5 të nenit 5 të Rregullores së Aksesit dhe interkoneksionit (cituat më sipër), sipas pikës 2 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, operatori ofruar mund të refuzojë dhënie të aksesit operatorit përfitues (në këtë rast AMC Albania) për një shërbim të caktuar (në këtë rast akses në pikë lokale/rajonale interkoneksioni), vetëm në bazë të kriterëve objektive si pamundëshmëria teknike apo nevoja për të ruajtur integritetin e rrjetit dhe ai ka detyrim ta provojë pamundësinë e

ofrimit të këtij shërbimi. Argumentat e Albtelecom për mos-dhënie aksesit në pikë lokale/rajonale interkoneksioni janë dhënë në pretendimet e dërguara për këtë procedim administrativ (njëkohësisht edhe në diskutimet e kryera për RIO e Albtelecom në 2008-2009), të cilat gjykojnë se janë të pjesshme pasi Albtelecom nuk ka dhënë detaje dhe afate të kalimit në NGN/NGA, megjithatë ka filluar tashmë këtë ndryshim të rrjetit.

9. Dhënia nga Albtelecom e aksesit në pika lokale/rajonale interkoneksioni për OC ka avantazhe dhe disa disavantazhe për OC, Albtelecom dhe tregun:
 - d. Përfitimi i tarifave të terminimit lokal/rajonale zvogëlon detyrimet neto të OC për trafikun e terminuar apo edhe të tarzitur në Albtelecom por për të përfituar akses në pika lokale/rajonale interkoneksioni operatorët celularë se pari do të duhet të bëjnë lidhje shtesë në këto pika. Aktualisht OC janë të lidhur në centralin transit kombëtar në Tiranë dhe për të përfituar terminim lokal duhet të lidhen në centralin përkatës lokal (për qytetin e Tiranës në TR1 dhe TR2), madje edhe për terminim njëfish në Tiranë do të duhet të lidhen në centralin rajonal të Tiranës (ky central mund të jetë në të njëjtin vendndodhje me centralin transit kombëtar Tiranë por do të ketë kosto shtesë të lidhjes me pjesën rajonale të centralit).
 - e. Lidhja e OC me pika lokale/rajonale interkoneksioni jashtë Tiranës, në kushtet kur secili OC ka MSC vetëm në Tiranë, do të çojë në rrugëzime të thirrjeve jo efektive: thirrja e një abonenti celular nga një rreth do të vijë në MSC-Tiranë dhe më pas do të shkojë përsëri në pikën e interkoneksionit të OC me Albtelecom në këtë rreth. Në këtë rast rrugëzimi i thirrjes nga OC drejt kësaj nyje në rrjetin Albtelecom kryhet nga OC dhe që normalisht ka kosto më të lartë se rrugëzimi nga Albtelecom.
 - f. Albtelecom do të duhet të investojë në centralet lokale kapacitete dhe aftësi shtesë. Sipas Albtelecom këto investime do të dalin jashtë përdorimit për një kohë të shkurtër për shkak të kalimit në NGN/NGA. Ky argument gjykohet nga AKEP se është i vlefshëm për investimet në centralet lokale por për centralet rajonale gjykojmë se ato do të shërbejnë ende si pika nyje në rrjetin NGN për rrjetin e transmetimit.
 - g. Në rast se reduktimi neto i detyrimeve të OC i kalon abonentëve fundorë për tarifën më të ulët drejt Albtelecom, atëherë përfitojnë edhe konsumatorët. Megjithatë bazuar në historikun e tarifave celulare si dhe pjesën e vogël që zë terminimi fikse në tarifën me pakicë celulare drejt fiksit, si dhe pjesën e vogël të thirrjeve celular-Fiks në thirrjet e përdoruesve celularë, ky përfitim është pak i mundshëm (madje është pak e mundshme të fillojë aplikimi i tarifave celulare drejt fikse me zona lokale rajonale dhe kombëtare. Kjo do të çojë në tarifën me diferencë absolute shumë të vogël 1-2 lek/minute krahasuar me rreth 20 lek/minute të thirrjes aktuale.

10. Niveli aktual i tarifës së terminimit në segment dyfish si edhe segmentet e tjera te terminimit në Albtelecom janë të përkoheshme dhe pritet që ato të reduktohen brënda vitit 2011.
11. AKEP vlerëson se Albtelecom duhet të japë akses në segment dyfish (akses në central transit kombëtar) dhe segment njëfish për rajonin e Tiranës. Aksesit në pikën rajonale të interkoneksionit për AMC do të duhet të kryhet nëpërmjet një lidhje të re në centralin rajonal të Tiranës midis AMC dhe Albtelecom, sipas përcaktimeve të RIO dhe tarifave në fuqi të Albtelecom.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1502 datë 10.02.2011 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Albtelecom sh.a dhe AMC sh.a.;
2. Albtelecom të plotësojë kërkesën e AMC për dhënie të aksesit në pikën rajonale të interkoneksionit në Tiranë, përveç aksesit në pikën kombëtare të Interkoneksionit.
3. Tarifat, modalitetet dhe afatet e implementimit të pikës së re të interkoneksionit midis palëve të jenë sipas ofertës referencë në fuqi të Albtelecom dhe vendimeve të AKEP.
4. Të njoftohen palët e interesuara Albtelecom sh.a dhe AMC sh.a për mbylljen e procedimit administrativ;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**